



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 1/124

Datë: 13.05.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 maj 2010, mori

V E N D I M

1. Miratohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkriptet nga mbledhjet 121, 122 dhe 123 të Qeverisë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 2/124

Datë: 13.05.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 maj 2010, mori

V E N D I M

1. Miratohet Projektligji për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Kosovës.
2. Obligohet Sekretari i përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 3/124

Datë: 13.05.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 maj 2010, mori

V E N D I M

1. Miratohet Projektligji për qasje në dokumente publike.
2. Obligohet Sekretari i përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 4/124

Datë: 13.05.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit 5 të nenit 8 të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme, si dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 maj 2010, mori

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa për shpronësimin e pronave të paluajtshme në rrugën M9 nga Fushë Kosova deri në Arllat, rrugën M2 nga Prishtina deri në Mitrovicë dhe ngastrën 7497 sipas fletës poseduese Nr. 6590 në zonën kadastrale në Prishtinë.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të përcaktohet sipas kategorive përkatëse nga Ministria për Ekonomi dhe Financa e cila mbështet nga Ministria e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit dhe Komunitat në territorin e të cilave kalojnë zonat kadastrale që do të shpronësohen.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Ministria për Ekonomi dhe Financa, Ministria e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit dhe Komunitat në territorin e të cilave kalojnë zonat kadastrale.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 5/124


Datë: 13.05.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 3 dhe 5 të Ligjit Nr. 03/L-87 për Ndërmarrjet Publike, si dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 maj 2010, mori

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, në cilësinë e ushtruesit të ligjshëm të drejtave të aksionarit të Republikës së Kosovës në Ndërmarrjen Publike "Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh. A" ("PTK"), vendos se Ministri për Ekonomi dhe Financa (Ministri), në rolin e tij si Kryesues i Komisionit Ndër-Ministror për NP, autorizohet dhe urdhërohet të veprojë në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, si aksionar i vetëm në PTK, dhe të ndërmarrë të gjitha masat e ligjshme, të nevojshme dhe të përshtatshme të aksionarit për realizimin e veprimeve në vijim në periudhën më të shkurtër kohore të mundshme ligjërisht:
 - 1.1. PTK dhe Bordi i saj i Drejtorëve menjëherë të deklarojnë dhe paguajnë një dividendë ("Dividenda") për aksionarin në shumën prej 80,000,000 (tetëdhjetë milion) euro;
 - 1.2. PTK dhe Bordi i saj i Drejtorëve të sigurojnë që PTK menjëherë të vendosë një ngrirje gjithëpërfshirëse të nivelit të pagave dhe të punësimit të punonjësve të rinj dhe, duke marrë parasysh faktin se çështjet e punësimit do të rregullohen në marrëveshjen e privatizimit, që PTK të mos vazhdojë ose përtërijë kontratat ekzistuese të punës përtej datës 31 dhjetor 2010. Megjithatë, ky nënparagraf nuk ndikon në të drejtat ekzistuese të punonjësve në bazë të kontratave aktuale të vlefshme të punës;
 - 1.3. PTK dhe Bordi i saj i Drejtorëve të sigurojnë që PTK të mos zbatojë asnjë projekt kapital ose shpenzim të ri i cili nuk është paraparë në planin e biznesit të aprovuar nga aksionari; dhe

- 1.4. PTK dhe Bordi i saj i Drejtorëve të sigurojnë sa më shpejt që të jetë ligjërisht e mundshme që PTK të ndërpresë të gjitha shpenzimet ose detyrimet kontraktuese të cilat përcaktohen nga Komisioni Ndër-Ministror për Ndërmarrjet Publike që nuk ndodhen në planin e biznesit të aprovuar nga aksionari.
2. Ngarkohet Ministri për Ekonomi dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 6/124

Datë: 13.05.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në cilësinë e ushtruesit të ligjshëm të drejtave të aksionarit të Republikës së Kosovës në Ndërmarrjen Publike "Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.A" ("PTK"), dhe pas rekomandimit të Komisionit Ndërministror të themeluar me vendimin numër 02/41 si dhe në pajtim me nenin 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, në mbledhjen e mbajtur më 13 maj 2010

REKOMANDON

1. Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit të Republikës së Kosovë i rekomandohet që të mos jap licencë për operatorin e tretë të telefonisë mobile në Kosovë për pesë vitet e ardhshme duke pasur parasysh faktin se dhënia e një licence të tillë për operatorin e tretë të telefonisë mobile do ta ulte ndjeshëm dhe në masë të madhe vlerën e PTK-së dhe do të ndikonte ndjeshëm në procesin e pjesëmarrjes së sektorit privat në PTK.
2. Rekomandimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 7/124

Datë: 13.05.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 maj 2010, mori

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Energjisë dhe Minierave për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 160,000.00 (njëqind e gjashtëdhjetë mijë) euro për fillimin e themelimit të Njesisë për Menaxhimin e Projektit "Hidrocentrali Zhur" dhe Këshilltarëve të transaksionit.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi do të sigurohen gjatë proceseve të rregullta të rishikimit të buxhetit për vitin 2010.
3. Ngarkohet Ministria për Ekonomi dhe Financa dhe Ministria e Energjisë dhe Minierave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 8/124
Datë: 13.05.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe nenit 62 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L si dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 maj 2010, mori

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës për anëtar të Bordit Këshillëdhënës për Mbrojtjen e Mjedisit i rekomandon Kuvendit këta kandidatë:
 - Behxhet Mustafa;
 - Sylejman Berisha;
 - Islam Fejza;
 - Kemail Bislimi;
 - Nysrete Doda - Gashi;
 - Tush Markaj;
 - Luan Shllaku;
2. Obligohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që emrat e kandidatëve të përcaktuar në pikën 1. të këtij vendimi, së bashku me CV-të e tyre, t'ia procedoj për miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 9/124

Datë: 13.05.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 2003/14, dhe Ligjit Nr. 03/L-106 Për Ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor si dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 maj 2010, mori

V E N D I M

1. Për anëtarë të Këshillit për Planifikim Hapësinor emëron këta kandidatë:

- Ruzhdi Pllana;
- Ylber Vokshi;
- Ilir Gjinolli;
- Laura Kusari -Limaj;
- Xhelal Llonçari;
- Dervish Qerreti;
- Adem Pajaziti;

2. Këshilli për Planifikim Hapësinor sipas pikës 1. të këtij vendimi detyrat dhe përgjegjësit do t'i ushtrojë në pajtim me Ligjin për Planifikim Hapësinor Nr. 2003/14, dhe Ligjin Nr. 03/L-106 për Ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/124
Datë: 13.05.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 maj 2010, mori

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në shumë prej 11.000 (njëmbëdhjetëmijë) euro për mbulimin e shpenzimeve për shoqatën e matematikanëve të Kosovës.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga:
 - 2.1. Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë 3500 (tremijepesëqind) euro;
 - 2.2. Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve 3500 (tremijepesëqind) euro dhe
 - 2.3. Zyra e Kryeministrit 4000 (katërmijë) euro.
3. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi derdhen në xhirrollogarinë e Shoqatës së Matematikanëve të Kosovës nr. 1110295960000119 në Pro Credit Bank.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria për Ekonomi dhe Financa Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe Zyra e Kryeministrit.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/124

Datë: 13.05.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 maj 2010, mori

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e deputetit z. Ali Lajçi për mbulimin e shpenzimeve të shërimit.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga rezervat e Qeverisë, shpenzime të paparashikuara, dhe derdhen në xhirrollogarinë bankare të z. Ali Lajçi pas sjelljes së faturave të shpenzimeve.
3. Ngarkohet Ministria për Ekonomi dhe Financa për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeminister i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë